



Data: 25.09.2018

Ref.: 1121/180

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 59-të, të mbajtur më 12 shtator 2018, mori:

## V E N D I M

- I. Nuk Riakreditohet programi i studimit të BPrAL Kolegji "Pjetër Budi":
- Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS ( me specializime: 1. Menaxhimi i Resurseve Njerëzore; 2. Banka dhe Mbikëqyrje Financiare; 3. Menaxhim Marketingu; 4. Administratë Publike; 5. Sigurime).
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Pjetër Budi" ka parashtruar kërkesë (Kërkesa nr. 662/16, datë 14.11.2016) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA), për ri/akreditim të programit të studimit Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Administrim Biznesi	BA	180	Seadin Xhafer, Elez Osmanoviq, Lule Beqa.

- I. Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (tash e tutje KSHC), bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditim Nr. 20/16, datë 20.09.2016 (tash e tutje UA për Akreditim), neni 14, pika 1, sipas së cilës: "Secili aplikacion për akreditim nga një Institucion i Arsimit të Lartë (IAL) duhet të kalojë nëpër vlerësimin preliminar për të siguruar se institucioni i plotëson kërkesat e përgjithshme për akreditim sipas kritereve të caktuara nga AKA" ka trajtuar aplikacionin në fjalë. Aprovimi formal i aplikacionit në fjalë, është bërë bazuar në faktin që Kolegji Pjetër Budi kishte prezantuar stafin akademik në marrëdhënie të rregullt.

Me pastaj AKA, bazuar në nenin 13, pika 1.1, sipas se cilës: *“Nëse vlerësimi preliminar është pozitiv, AKA do të vazhdojë me fazën e dytë të procedurës së akreditimit”*, ka aprovuar aplikacionin në fjalë dhe ka vazhduar me procedurat e mëtutjeshme. Ne koordinim me institucionin, duke organizuar vizitën në Kolegjin “Pjetër Budi” më 04.07.2017, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Volker Gehmlich, Peter Normak.

Gjatë vizitës së realizuar në këtë institucion, ekspertët kanë vlerësuar edhe stafin akademik si njëra nga komponentët kryesore të implementimit të programit të studimit. Gjithashtu rendësi të veçantë gjatë kësaj vizite i është kushtuar stafit akademik të cilët ishin bartës të programit të studimit. Pas vizitës së realizuar me 4 Korrik 2017, Ekspertet e akreditimit kanë hartuar raportin final, ku edhe kanë rekomanduar akreditimin e programit të studimit bazuar në stafin akademik të cilët janë vlerësuar nga ana e tyre.

Në ndërkohë Kolegji Pjetër Budi ka ndryshuar stafin akademik, përkatësisht ka ndryshuar bartësit e programit me të cilët ishte aprovuar aplikacioni nga KSHC dhe është vlerësuar dhe rekomanduar nga ekspertët. Nga tre bartësit e programit të studimit, Seadin Xhafer, Elez Osmanoviq dhe Lule Beqa, institucioni ka hequr dy nga ta si bartës, duke sjell në AKA një përbërje tjetër nga ajo e aprovuar dhe vlerësuar nga ekspertët. Kolegji Pjetër Budi, si bartës të programit pas vlerësimit nga ana e ekspertëve kishte vendosur: Mahije Mustafi, Pece Nikolovski, Elez Osmanovic, Alba Papallazo Dumi. Nga kjo përbërje shihet çartë se vetëm Elez Osmanovic është aprovuar nga KSHC dhe vlerësuar nga ekspertët e akreditimit. Ndryshimi i stafit akademik, dhe në veçanti i bartësve të programit të studimit pas vlerësimit nga ana e ekspertëve është e papranueshme, pasi që ky staf i ri nuk ka mundësi të vlerësohet nga askush.

- II. Përveç fakteve të cekura me sipër, personat e prezantuar nga Kolegji Pjetër Budi si bartës i këtij programi jashtë çdo afati dhe pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga ana e ekspertëve, dy nga ta, përkatësisht Pece Nikolovski ka marrëdhënie të rregullt të pune edhe në University "St. Kliment Ohridski" – Bitola në Maqedoni, ndërsa Alba Papallazo Dumi ka marrëdhënie të rregullt të punës në Universitetin “Ismail Qemali” në Vlore në Shqipëri, dhe rrjedhimisht nuk mund të pranohen si bartës të programit të studimit. Bazuar në faktet e prezantuara me sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “Pjetër Budi”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

